



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

<b>Datë :</b>	<b>03.05.2017</b>
<b>Referencë</b>	<b>11-344/4</b>
<b>Për :</b>	<b>Kryetar i Komunes-z. Imri Ahmeti</b>
<b>Përmes :</b>	<b>Drejtpërsëdrejti</b>
<b>Nga :</b>	<b>Drejtori i Drejtorisë të Inspektoratit - z. Imer Rrustemi</b>
<b>Lënda :</b>	<b>RAPORTI MUJOR-PRILL</b>

## Pasqyra tabelare e punës për muajin –PRILL

Inspektorët	Gjithsej																			
Biznesit	535	35	16			75	1	1	102				4	131	122			16		32
Ambientit	276	55				3			83					27	103			5		
Bujqësisë	106	7				30			16						40				13	
Ndërtimtarisë	48	17		1					15		3			6		5		1		
Trafikut	418	35		1		89			49			137	8		31			68		
Sanitar	92	12		3	12	20			16	1					14		14			
Gjithsejtë	<u>1475</u>	<u>161</u>	<u>16</u>	<u>5</u>	<u>12</u>	<u>2171</u>	<u>1</u>	<u>1</u>	<u>281</u>	<u>1</u>	<u>3</u>	<u>137</u>	<u>12</u>	<u>164</u>	<u>310</u>	<u>5</u>	<u>14</u>	<u>90</u>	<u>13</u>	<u>32</u>

Gjatë muajit Prill kemi hasur në 17 biznese të pa regjistruara në qendrën e regjistrimit të biznesit ku janë urdhëruar me procesverbal dhe me aktvendim që të bëjnë regjistrimin e tyre pranë qendresë së regjistrimit të bizneseve ARBK-së, Lipjan. Gjithashtu kemi pasur 18 biznese pa pranime teknik te lokaleve afariste për plotësimin e kushteve tekniko higjenike ku janë urdhëruar me procesverbal dhe aktvendim që të aplikojnë pranë Drejtoratit të Inspektoratit tek Inspektoret e Tregut.

Në bazë të kërkesave të bizneseve kemi bërë pranime teknike me procesverbal për plotësimin e kushteve tekniko higjenike minimale për të ushtruar veprimtarin e tyre.

Kemi mbyllur një biznes për shkak se nuk ka qen i regjistruar në MTI, dhe nuk ka pasur pëlqim nga inspektoret e tregut për të ushtruar aktivitetin biznesor.

Gjatë muajit është bërë inspektimi i disa subjekteve afariste si, kioske, furra të bukës, mishore, restorante si dhe inspektimi i ëmbëltove. Gjatë muajit janë bërë disa inspektime të përbashkëta me Inspektor Sanitarë të AUV-it, po ashtu inspektime janë bërë edhe me Inspektor Veterinarë të AUV-it.

Në thertore janë inspektuar kafshët për therje, ku gjithësejt janë therë 14 dema.

Gjatë muajit Prill është inspektuar në disa fshatra si në fsh.Babush i Muhaxhirëve, Glllogoc, Sillovi, Blinajë, Magure, Janjevë etj. Inspektimi është bërë në bazë të kërkesave të palëve dhe planit tonë në lidhje me ndotjen e mjedisit në përgjithësi. Në qytetin e Lipjanit është inspektuar në një biznes në lidhje me zhurmën, me ç'rast janë marë masat e nevojshme sipas Ligjit.

Është inspektuar në të gjitha bizneset që shfrytëzojnë hapësirën publike dhe me procesverbal dhe Aktvendim janë urdhëruar që të pajisen me pëlqim për shfrytëzim të këtyre hapësirave.

Në muajin Prill është bërë inspektim në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari“ në Vrellë në bashkëpunim me policin kufitare për auto-taksi të cilët po tentojnë të ushtrojnë veprimtari ilegale. Është bërë inspektimi i kompanive të autobusëve në relacione të ndryshme që operojnë në këtë territor se mos ka ndonjë vonesë në rendin e udhëtimit, si dhe kontrollimi i auto-taskive që janë te parkuar në parkingjet e auto-taksit se po hasim ndonjë duke ushtruar veprimtari pa u pajisur me licencë.

Kemi bërë edhe inspektimin e tregjeve si tregu i gjelbërt, kafshëve dhe i mobileve.

Gjatë këtij muaji janë inspektuar marketet ushqimore për produkte me prejardhje bimore, po ashtu janë inspektuar tokat bujqësore që u është ndërruar destinimi, ato që janë mbushur me materiale të ndryshme dhe që posedonin pëlqime nga organet kompetente i u është dhënë urdhëresa për rrafshim dhe nivelizim të terrenit, janë inspektuar plantacione me pemë dekorative dhe pemishte frutdhënëse ku kanë pësuar dëmtime nga temperaturat e ulëta.

Për të gjitha parregullsitë është dhënë urdhër me procesverbale për evitimin e tyre, për çdo shkelje është vepruar konform ligjeve në fuqi.

Gjatë muajit Prill janë inspektuar objekte të ndryshme ndërtimi. Objektivë kryesore e inspektoreve të ndërtimit është ndalimi i punimeve pa leje ndërtimore në bazë të Ligjeve të Ndërtimit. Ku nuk kemi lejuar asnjë objekt ndërtimor të ndërtohet pa leje ndërtimore.